



**AUTORITETI SHETËTOR PËR  
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

Nr. 76 prot. Tiranë, më 29.01 2025



**UNIVERSITETI I TIRANËS**

Nr. 3436 prot. Tiranë, më 29.01 2025

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

ndërmjet

**AUTORITETIT SHETËTOR PËR INFORMACIONIN  
GJEOHAPËSINOR**

dhe

**UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Sot, me datë 29 / 01 / 2025 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

**AUTORITETI SHETËTOR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG)**, institucion publik qendror, me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, Kati i dytë, Tiranë i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, misioni i të cilit është krijimi i infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, sipas standardeve evropiane të Direktivës 2007/EC “INSPIRE”. ASIG përfaqësohet ligjërisht nga **Drejtori i Përgjithshëm Znj. Vilma Tomço**;

(në vazhdim ASIG)

**dhe**

**UNIVERSITETI I TIRANËS (UT)**, institucion universitar i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, me adresë: (Rektorati) Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë. Universiteti i Tiranës ushtron misionin e tij në zhvillimin e shoqërisë përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik, kërkimit shkencor, edukimit si dhe shërbimit ndaj publikut, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti i Tiranës përfaqësohet ligjërisht nga **Rektori Z. Artan Hoxha**;

(në vazhdim UT)

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “Pala” ose bashkërisht si “Palët”.

## **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta; rritjen e kapaciteteve njerëzore përmes përgatitjes së specialistëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vend; kryerjen e ekspertizave kërkimore dhe integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor, për përdorimin e mundësive që krijon teknologjia në fushën e gjeoinformacionit.

### **Neni 2**

#### **Fusha e Bashkëpunimit**

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjeje*, fushat e bashkëpunimit midis dy insitucioneve do të fokusohen në këto veprimtari kryesore:

- 2.1 Identifikimin, nxitjen, mbështetjen dhe bashkëpunimin në projekte me interes të përbashkët, për të dyja palët, në fushën e gjeoinformacionit, teknologjisë së informacionit, promovimit dhe marketingut të produkteve, objekt të projekteve të përbashkëta;
- 2.2 Bashkëpunimin për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, organizimin e përbashkët të konferencave, simpoziumeve, kongreseve, seminareve, kurseve, shkollave verore, punëtorive dhe formave të tjera të bashkëpunimit me interes në fushën e gjeoinformacionit;
- 2.3 Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera të përbashkëta në fushën e arsimit, trajnimit dhe/ose kërkimit.
- 2.4 Shkëmbimin e njohurive (literaturës profesionale, teksteve shkollore dhe botimeve të tjera universitare) dhe të dhënave që avancojnë interesin reciprok të palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e secilës palë;
- 2.5 Shkëmbimin e materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore të lidhura me aktivitetin e të dy palëve në respekt të parimit të konfidencialitetit dhe mirëbesimit;

- 2.6 Rrjetëzimi dhe shkëmbimi i ndërsjellë i mësimdhënësve, studiuesve, studentëve dhe personelit tjetër për ligjërata dhe shkëmbim përvojash me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kurikulave, dhe të punës kërkimore shkencore;
- 2.7 Informimin në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme midis palëve për përmbushjen e angazhimeve në këtë marrëveshje si dhe për zhvillimet në secilin institucion, që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palës tjetër;
- 2.8 Krijimin e hapësirave institucionale për zhvillimin e trajnimeve sipas nevojave të palëve;
- 2.9 Organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 2.10 Krijimin e hapësirave për praktika profesionale dhe mësimore të studentëve në fushën e gjeoinformacionit si dhe udhëheqje të përbashkët të projekteve të ndryshme, të doktoratës (tema të doktoratës) etj;
- 2.11 Komunikim efektiv ndërmjet tyre për të organizuar projekte ose veprimtari të tjera me interes për të dyja palët.

### Neni 3

#### Angazhimet dhe të Drejtat e Palëve

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, palët angazhohen të identifikojnë dhe të zbatojnë projekte konkrete bashkëpunimi në fushën e gjeoinformacionit.
- 3.2 Palët angazhohen të shkëmbejnë ekspertizë dhe mbikëqyrje të përbashkët të veprimtarisë kërkimore shkencore të cilat vijnë si rezultat i këtij bashkëpunimi.
- 3.3 Palët do të informojnë për organizimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nga ana e tyre ose në bashkëpunim me institucione apo organizata homologe, vendase apo ndërkombëtare.
- 3.4 Palët marrin përsipër të angazhohen në lidhje me programin e praktikave mësimore të studentëve duke pranuar njëri-tjetrit si partnerë në fushën e gjeoinformacionit.
- 3.5 Palët angazhohen të vënë në dispozicion të njëri-tjetrit dhe të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacionin që disponojnë për qëllime jofitimprurëse, duke marrë masa për mbrojtjen e këtyre të dhënave nga përdorimi i paautorizuar i tyre.

### Neni 4

#### Kufizimet e Marrëveshjes

- 4.1 Për çdo veprimtari që përputhet me frymën e kësaj marrëveshje, palët kanë të drejta të bien dakord mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.
- 4.2 Kjo marrëveshje nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.
- 4.3 Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, bazuar në parimet e mësipërme lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me marrëveshje të veçanta financiare të cilat do të jenë pjesë integrale e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
- 4.4 Palët bien dakord që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

## Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes



- 5.1 Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjecare, nga data e nënshkrimit. Palët mund të negociojnë zgjatjen e vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje përpara përfundimit të saj. Në çdo rast, ndryshimet do të shkëmbehen në formë zyrtare me shkrim.
- 5.2 Çdo nen i marrëveshjes mund të ndryshohet, amendohet ose revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi paraprak reciprok të dy palëve nënshkruese.

## Neni 6 Konfidencialiteti

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshjeje merr përsipër të mos bëjë të ditur, përhapë apo komunikojë tek subjekte të tjera informacione, të dhëna, dokumente në lidhje me veprimtarinë dhe ekzistencën e kësaj marrëveshjeje, si dhe çdo informacion apo komunikim tjetër që në atë kohë nuk janë të njohura nga publiku, dhe për të cilat ajo vihet në dijeni ose merr si rezultat i nënshkrimit ose zbatimit të kësaj marrëveshjeje (“Informacioni Konfidencial”), përveç me miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.
2. Secila palë merr përsipër të mos përdorë Informacionin Konfidencial për qëllime të tjera përveç qëllimit të zbatimit të angazhimeve të saj sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Palët angazhohen të ruajnë të dhënat sensitive, personale dhe privatësinë e informacionit që mund të disponojnë si pasojë e bashkëpunimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe t'i administrojnë këto të dhëna në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky detyrim i ndërsjellë i palëve për konfidencialitetin do të vijojë të ketë pasoja juridike edhe pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 7 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve midis Palëve

- 7.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim midis palëve.
- 7.2 Në mungesë të mirëkuptimit midis palëve, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**Neni 8**  
**Njoftimet mes Palëve**

- 8.1 Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

**Për Universitetin e Tiranës:**

**Person Kontakti:** Prof. Assoc. Dr. Sonila Xhafa Sinjari

**E-mail:** [sonila.xhafa@fhf.edu.al](mailto:sonila.xhafa@fhf.edu.al)

**Mobile:** +355684090196

**Për ASIG:**

**Person Kontakti:** Dritan Domi

**E-mail:** [dritan.domi@asig.gov.al](mailto:dritan.domi@asig.gov.al)

**Mobile:** +355682038230

- 8.2 Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet eventuale të përfaqësuesve.

**Neni 9**  
**Dispozita të Përgjithshme**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe pasi lexohet nënshkruhet nga të dyja palët.

**PËR**  
**AUTORITETIN SHTETËROR PËR**  
**INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Zj. Vilma Tomço**



**PËR**  
**UNIVERSITETIN E TIRANËS**

**REKTOR**  
**Prof. Dr. Artan Hoxha**

